

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatmire Podvorica dhe Bashkëpunëtoren Profesionale Valbonë Fejza, në çështjen penale kundër të akuzuarit **M.(B.) B.** nga P., rr:”...”, pnr., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.7088/17, dt.08.08.2018 duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorit të Shtetit për dhënien e Urdhërit Ndëshkimor - Dënim me gjobë, jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor, më datë 14.09.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari

M.B., nga i ati B. dhe nëna Xh., i lindur më datë *data e lindjes...*, nga P., rr:”...” pnr., ku edhe tani jeton, me numër personal të identifikimit: *numri personal...*, Shqiptar-Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e:

Me datë 11.11.2017, rreth orës 14:03 në rrugën P.-P. tek kthimi në fshatin L. duke e drejtuar veturën “VW-JI- Golf”, ngjyrë hiri metalike, me targa të regjistrimit *targat e regjistrimit...*, nga pakujdesia kishte vepruar në kundërshtim me nenin 53 par.1 dhe nenin 120 par.1 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, ka rrezikuar pjesëmarrësit në komunikacion duke vënë në rrezik jetën e njerëzve në atë mënyrë që duke lëvizur me shpejtësi të papërshtatur me kushtet e rrugës dhe duke mos mbajtur distancën e sigurisë në mes veturave, ka goditur veturën e cila ishte ndalur para tij të tipit “VW-Golf”, ngjyrë e zezë, me targa të regjistrimit *targat e regjistrimit...* të cilin e drejtonte A.B. i cili për shkak të inercisë është shtyrë deri te vetura e ndalur e tipit “VW-1K”, ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit “*targat e regjistrimit...*”, të cilin e drejtonte B.H. me ç’rast lëndime të lehta trupore me pengesa të përkohshme për shëndetin kanë pësuar A.B., F.G., K.G., A.K. dhe A.B.,-

-me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4, 7, 41, 42, 43, 46, 73 dhe 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 365, 453, 463 dhe 495 të KPPRK-së, e:

G J Y K O N

I. Me dënim me gjobë, në shumën prej **dyqind (200) Euro**, të cilin dënim i akuzuari është i detyruar t'a paguajë në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë, atëherë gjykata do t'ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke i'a llogaritur 1 (një) ditë burgim, me njëzet (20) Euro të gjobës.

III. Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën 40.88 Euro për ekspertizë të komunikacionit ndërsa shumën prej 50,00 Euro për ekspertizën mjeko ligjore, kurse në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20.00 Euro, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV. Detyrohet i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të paguajë shumën prej 30 Euro, brenda afatit prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

V. Të dëmtuarit A.B., F.G., K.G., A.K. dhe A.B. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzë në këtë Gjykatë PP/II.nr.7088/17, dt.08.08.2018, kundër të akuzuarit M.(B.)B. nga P., rr:"...", pnr., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe ka kërkuar që të njëjtit t'i shqiptoj Urdhër Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me arsyetimin se ka prova të besueshme në shkresat e lëndës nga të cilat rezulton se i akuzuari vërtetë ka kryer vepër penale për të cilën akuzohet.

Sipas nenit 493 par.1 të KPPRK-së, për veprat penale për të cilat parashikohet dënimi me gjobë ose burgim deri në tri (3) vjet dhe ka prova të besueshme se vërtetë i akuzuari e ka kryer veprën penale, në kërkesë të Prokurorit të Shtetit në aktakuzë, gjykata mund t'a aprovoj kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor dhe të akuzuarit t'ia shqiptoj dënimin e propozuar si në kërkesë.

Sipas nenit 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, për të këtë vepër penale është paraparë dënim me gjobë ose dënim me burgim deri në 3 (tri) vite. Po ashtu Prokurori i Shtetit kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor ia ka bashkangjitur edhe prova të besueshme nga të cilat prova rezulton se i akuzuari vërtetë e ka kryer veprën penale si në aktakuzë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas shqyrtimit paraprak të shkresave të lëndës dhe bazuar në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe atë në mendimin dhe konstatimin e ekspertit të komunikacionit, Ingj.A.P. i dt.31.05.2018, mendimin dhe konstatimin e ekspertit të mjekësisë ligjore Dr.N.H., i dt.09.06.2018, deklarata e të akuzuarit dhënë në Polici, deklarata e të dëmtuarve-dëshmitarve dhënë në polici, skicën e vendit të ngjarjes, foto-dokumentacionin duke e aprovuar kërkesën e Prokurorit të Shtetit për dhënien e urdhrin ndëshkimor pa e mbajtur

shqyrtimin gjyqësor vlerësoi se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 495 të KPPRK-së dhe të akuzuarit ia shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mundësia e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 46 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe në emër të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.1 dhe 2.6 lidhur me nenin 453 të KPPRK-së.

Vendimi mbi kompensimin e viktimave është marrë në bazë të nenit 3.1 të Ligjit nr.05/L-036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në bazë të nenit 463 par. 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 495 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr. 545/18, dt.14.09.2018

Sekretare Juridike,
Fatmire Podvorica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Minir Hoti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi - Urdhri Ndëshkimor është i lejuar kundërshtimi brenda afatit prej 8 ditëve nga dita e pranimit të njëjtë, kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim Urdhri Ndëshkimor merr formën e prerë.